




REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-1340/13
Data Datum Date	07-05-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenin 18 paragrafi 4, 8 dhe 12 të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenin 26 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.04.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Ekziston konflikti i interesit** në rastin nr. AKK-03-4243/12, për z. **Sejdi Rexhepi** – Prorektor i Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe Kryesues i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës.
- II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik nr. 04/L-051, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, si dhe në bazë të Vendimit nr.03-4243/12, është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për zyrtarin e lartë, z. Sejdi Rexhepi – Prorektor në Universitetin “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe njëkohësisht Kryesues i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Me datën 04.12.2012 Zyrtarit të Lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese (Z.D/DPK-01-4343/12) me të cilën Agjencia ka njoftuar atë se ka filluar hetimin lidhur me dyshimin e bazuar për situatën konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Pas kësaj shkrese Zyrtari i Lartë është paraqitur në Agjenci, në ballafaqimin e fakteve, në takim me zyrtarët e Agjencisë.

Në këtë takim është bërë ballafaqimi i fakteve dhe është konstatuar me dokumente zyrtare se Zyrtari i Lartë, **Sejdi Rexhepi** është **Anëtar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës** që nga 16 maji 2008, me mandat pesë vjeçar (Vendimi nr.03-0504/DO-271) dhe njëkohësisht me datë 01.10.2012, me Vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, është zgjedhur **Prorektor për burime dhe infrastrukturë** në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, funksion ky që e sjell në situatë të konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, duke u bazuar në Ligjin për parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik Nr.04/L-051, Neni 16.1, në të cilin shprehimisht thuhet:

”Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, përjashtuar subjektet politike dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit”.

Ushtrimi i njëkohësishëm i këtyre dy funksioneve paraqet papajtueshmëri të funksioneve dhe përbënë - Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Kjo duke u bazuar edhe në Statutin e Universitetit të Prishtinës, i cili shprehimisht thotë: “Autoritetet kryesore qeverisëse të Universitetit janë Këshilli Drejtues, Rektori dhe Senati (Neni 16, paragrafi 1). Ndërsa Neni 43 paragrafi 1 i këtij Statuti, pos tjerash, ka paraparë edhe Prorektorët si anëtar të Senatit me të drejtë në vendimarrje (të drejtë vote).

Prandaj konform kësaj pike, Zyrtari i Lartë në takim është këshilluar nga Zyrtarët e Agjencisë për ate se çka është konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik, mënyren se si duhet parandaluar ate si dhe mënyren se si duhet shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Edhe përkundër afatit të dhënë ligjor nga Agjencia, Zyrtari i Lartë nuk ka ndërmarr asnjë veprim që të parandaloj dhe të shmangë këtë situatë, prandaj me datën 03.04.2013, i është bërë shkresa e dytë që quhet “Njoftim paralajmërues” (Z.D/DPK-01-1004/13) me të cilën, nga Zyrtari i Lartë, është kërkuar që brenda afatit të dhënë ligjor të ndryshoi këtë gjendje.

Pas shkresës sonë të dytë, Zyrtari i Lartë, z.Rexhepi, ka kthyer një shkresë Agjencisë (DPK/DPKI 03-1064/13) në të cilën ai pretendon se; nuk ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Më pastaj, z.Rexhepi nuk është përgjegjës me asnjë veprim konkret të bërë, për të ndryshuar situatën me konflikt interesi, në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Ne rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij (Neni 18 paragrafi 8).

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, “Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuar në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”.

Sipas Nenit 20 pika 2, "Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund t'i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit".

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në web faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

